



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1297 prot.

Tiranë, më 30.08. 2019

Lënda: Dërgohen rekomandime për projektligjin “*Për Organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës*”.

ZOTIT ULSI MANJA
KRYETAR

KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT
KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe në ushtrim të kompetencës të parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku sanksionohet se: “*Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues*”, pasi u njoh me projektligjin “*Për Organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës*” dhe relacionin shoqëruesh, dëshiron të parashtrojë sa më poshtë vijon, disa rekomandime në lidhje me këtë projektligj.

Rekomandim 1: Në pikën 1, të nenit 4 “*Parimet e veprimtarisë së Shërbimit të Provës*”, të shtohet parimi i proporcionalitetit.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shërbimit të provës kufizohen të drejtat dhe liritë e personit i cili është nën mbikëqyrjen e këtij shërbimi. Për këtë arsyre është e rëndësishme që, veprimtaria e shërbimit të provës të ushtrohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit, në mënyrë që

ndërhyrjet e shërbimit të provës të jenë të nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në vendim gjyqësor dhe ligj, mjetet dhe masta e përdorura të cenojnë sa më pak të drejtat e personit të mbikëqyrur dhe familjes së tij, mjetet dhe masat të jenë të përshtatshme për të arritur qëllimin dhe në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar.

Rekomandim 2: Pika 3, e nenit 4 “Parimet e veprimitarise së Shërbimit të Provës”, të riformulohet sipas kësaj përbajtje:

Veprimitaria e Shërbimit të Provës realizohet në respektim të parimit të njoftimit dhe komunikimit në një gjuhë të kuptueshme përmes një përkthyesi zyrtar, nëse personi nuk flet apo nuk kpton gjuhën shqipe dhe mënyrë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, sipas standarteve dhe legjislacionit në fuqi që rregullon çështjet e aksesueshmërisë në komunikim dhe informacion.

Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 1074 datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, ka përcaktuar standartet që duhen respektuar për të eleminuar barrierat në komunikim dhe informacion dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Formulimi i pikës 3, të nenit 4, të projektligjit, nuk është i saktë dhe i plotë, dhe nuk është gjithpërfshirës për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuari, siç janë personat me vështirësi shikimi ose plotësisht të verbër apo personat me aftësi të kufizuara të intelektit. Në lidhje me personin me vështirësi në dëgjim ose që nuk dëgjon dhe nuk flet, përkthimi duhet të ofrohet në gjuhën shqipe të shenjave, e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 837, datë 3.12.2014 “Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën Shqipërisë”.

Rekomandim 3: Pika 7, e nenit 4 “Parimet e veprimitarise së Shërbimit të Provës”, të riformulohet sipas kësaj përbajtje:

- Veprimitaria e Shërbimit të Provës zhvillohet pa asnjë diskriminim, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.**

Formulimi i pikës 7, të nenit 4, të projektligjit në lidhje me parimin e mosdiskriminimit, jo vetëm që nuk është i plotë dhe nuk përfshin të gjitha shkaqet e mbrojtura nga legjislacioni i posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligji Nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, por ka në përbajtje të tij terma jo të saktë siç janë, *pastësi, infeksion HIV/AIDS*. Termat e saktë janë aftësi e kufizuari dhe jetesa me HIV/AIDS. Për efekt edhe të teknikës legjislative, por edhe për të evituar në të ardhmen që ndryshimet e mundshme në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi të mos bien në kundërshtim me listimin e shkaqeve të mbrojtura në këtë ligj, (por

edhe në ligje të tjera) rekomandojmë që të bëhet referencë tek ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.

Pjesa përbullëse e pikës 7, të nenit 4, të projektligjit, ku thuhet “.....përveç rasteve të diskriminimit pozitiv, në përputhje me kushtetutën” nuk duhet të jetë pjesë e formulimit të parimit të mosdiskriminimit. Diskriminimi është diferenca në trajtim bazuar në një nga shkaqet e mbrojtura, për të cilën nuk ka një përligje objektive dhe të arsyeshme. Pra, jo çdo diferencë në trajtim përbën diskriminim, por vetëm ajo që nuk ka një përligje objektive dhe të arsyeshme. Diferanca në trajtim për të cilën ka një përligje objektive dhe të arsyehsme, nuk përbën diskriminim dhe nuk është e ndaluar nga ligji. Në thelb “diskriminimi” përbën gjënë e ndaluar nga ligji dhe përdorimi i terminologjisë “diskriminim pozitiv”, është një ndërthurje fjalësh, kuptimet e të cilave janë në kundërshtim me njëra-tjetren. Referuar Rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 32, të Komitetit për Eleminimin e Diskriminimit Racial, termi “diskriminim pozitiv” në kontekstin e standardeve të të drejtave të njeriut është një “contradictio in terminis” dhe duhet shmangur.

Rekomandim 4: Te gërrma “ç”, e nenit 6, “*Funksionet e shërbimit të provës*”, të shtohet që, shërbimi i provës adreson edhe problematikat në arsim dhe nevojat për mbrojtje sociale, të personit të mbikëqyrur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,



